

## Shtojca 8

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

sipas Shtojcës 5/1;

ç.Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d.Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

1. Te jete i licensuar per tregtimin e produkteve te tilla me pakice/ shumice.
2. Te kete ne historikun e ekstraktit te QKB-se sherbime te ketij lloji.

**2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

1. Te kete kryer sherbime te ngjashme ne vleren prej 40% te fondit limit qe prokurohet ne nje kontrate te vetme ose sa dyfishi i fondit limit te realizuar per 3 vitet e fundit, per kete OE duhet te paraqese kontrate furnizimi me AK ose fatura shitjesh me operator privat, si dhe formularin e vleresimit per sherbimin e kryer nga AK.
2. Kopje te bilanceve per 3 vitet e fundit te konfirmuara.
3. Vertetim per shlyerjen e detyrimeve vendore per vitin 2019.
4. Vertetim qe nuk ka detyrime vendore ndaj Bashkise Fushe- Arrez per vitin 2019.

**2.3 Për kapacitetin teknik:**

1. OE duhet te paraqese flete-analize te leshuar nga I SH T I per produktin per cilesine, sigurine ne tregtim dhe garancine e pikave te shitjes.
2. Vertetim nga I SH T I qe nuk ka patur penalizim per tregtim nafte jashte cilesise te leshuar nga I SH T I.
3. Certifikata ISO 9001: 2015, ISO 14001: 2015, OHSAS 18001:2007.
4. Deklarate qe OE merr persiper furnizimin 24 ore ne pikat e shitjes me pakice.
5. Kur ka BOE ky dokumentacion duhet te jete per te dy subjektet.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Nafta duhet te jete e tipit Blu Diezel.
- Levrimi per AK do te realizohet sipas kerkesave te tij.
- Furnizimi i mjeteve te AK do te realizohet nepermjet dorezimit te tollonave 10 L ose 20 L, prane cdo pike te tregtise me pakice ku OE eshte i licensuar.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

## **Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

Sasia e mallit që kërkohet: 35700 Litra

Afatet e lëvrimit: Sipas kerkesave te AK.